PAVARËSI PËR KOSOVËN

NGA SIR NOEL MALCOLM

THE NEW YORK TIMES, 18 QERSHOR 1999

THE NEW YORK TIMES
JUNE 18, 1999

Independence For Kosovo

By Noel Malcolm

I war is the continuation of policy by other means, then the West's failure to back Kosovo's quest for independence is a policy failure that now, at the eleventh hour, should be corrected.

It is no old story. You try to help a people who are oppressed and robbed by a brutal regime. It doesn't work, in part because of the limits of what outsiders can do, in part because the people you are trying to help are divided among themselves, and in part because your own leaders are uncertain and lack nerve. The oppressors, meanwhile, are certain and united, and they sense victory. In the end, your failure is total. Now Kosovo is the tragic demonstration of that truth.

Nineteen months ago NATO sent a force to Kosovo. President Clinton later declared America's commitment unbreakable. He spoke wise words about "the rights of all people, Albanians and Serbs alike, to live in peace and security." "We do not seek to punish Serbia," he said. "We seek to change her." Russian spokesmen said the bombing was illegal but predicted that it would work. It did not. President Milosevic outlasted our will. By October he was looking forward to winter and victory.

At no point, until Serbia all but announced a decision to quit, did anyone in the West seriously discuss victory's meaning: independence for Kosovo. That was always Milosevic's goal: to eliminate the Albanian nation he had sworn to destroy.

Part of Milosevic's success was the disunity of the West, and part was America's feeble reluctance to use its overwhelming force. But the principal reason was our collective refusal to define the goal: independence for Kosovo, and freedom from Serbian rule.

Some Western commentators said that independence for Kosovo was "too extreme." But in war there is no halfway. You either win or lose. Milosevic understood that truth. For years he steadily dressed up a wild, expansionist policy. He mobilized "his" Serbs in Serbia, even more in cruelty than in war, and made it plain that his goal is a Greater Serbia. He explained openly that the Albanian nation has no rights and that the only future for Kosovo's Albanians is exile (*Arbanasi Ahtjar ne Turke*) or grave.

Yet, for the most part, Americans and Europeans closed their ears. They professed to seek a political solution within Yugoslavia and Serbia. Why? Because that was "pragmatic"; because it was "realistic"; because they feared "extremism" and "instability." But there is nothing stable in injustice.

> Nationhood, not partition, is the only good choice.

Without vision, any achievement becomes harder. Kosovo's liberation will come one day, and then it will be harder still to create the conditions for a stable and just peace. Under Serbian rule, Albanians cannot stay. Any future short of independence means more refugees, more hatred and more war.

The independence of Kosovo is in America's interest. It will strengthen America's moral leadership, and it will make the world safer for America's friends and allies. It is also in Russia's interest. Russia's leaders say they oppose the bombing, but they know better. They know that support for Milosevic endorses Russia to Serbia's failures and crimes, and weakens Russia in the world.

The independence of Kosovo is in Europe's interest. It will, at nothing else can, stabilize the Balkans and strengthen the hand of all who seek a Europe both whole and free.

It is in the interest of Serbia herself. Milosevic has already done great harm to his people and his state. He has led them to more disaster. Only when he is removed can Serbia begin to recover and take her place in the family of democratic nations.

Serbs and others loyal to the old past forward one word: No! In their minds "No!" to independence for Kosovo means preservation of nationhood.

Yet nationalism preserves no nation; and Milosevic's version of Serb nationalism will not keep Serbs safe in Kosovo or anywhere else. It will not preserve Serbia. It will only lead to more war, more destruction and more isolation. Serb nationalism has already destroyed the best parts of Serbian culture; and it has forfeited the respect of the world. It is time to say "No!" to a false vision of nationhood.

Only nationhood consistent with freedom and democracy has any future. Independence for Kosovo is consistent with freedom and democracy for all. It offers the hope of a Europe at peace with itself.

Kosovo's future is part of the future of Europe. If Europe falters now, it will weaken itself and betray its highest values. The European Union cannot neutralize to the world unless it lives those values now, in Kosovo. The longer Europe delays independence for Kosovo, the weaker it becomes in the world.

President Clinton's leadership has sustained American power and influence, and has inspired the hopes of millions. Do not now let history record another failure of nerve. The independence of Kosovo is the only basis for a just peace.

Support independence for Kosovo. Support the Kosovar people in their heroic, nonviolent struggle for freedom. Lead the world in this last best chance to right a terrible wrong. Take the chance before it is lost.

The hour is late. But it will not be too late if America, Europe and Russia now choose the good and honorable path: independence for Kosovo. Then the future can be different. The future can be peaceful. The future can be free.

The New York Times

PAVARËSI PËR KOSOVËN

Nga Sir Noel Malcolm

The NeW York Times, 18 qershor 1999

Nëse lufta është vazhdim i politikës me mjete të tjera, atëherë dështimi i Perëndimit për të mbështetur kërkesën e Kosovës për pavarësi është një dështim politik që, duhet korrigjuar menjëherë!

Ekziston një histori e vjetër. Përpiqesh të ndihmosh një popull që është i shtypur dhe i plaçkitur nga një regjim brutal. Nuk funksionon. Pjesërisht për shkak të kufijve të asaj që mund të bëjnë të huajt; pjesërisht sepse njerëzit që po përpiqesh të ndihmosh janë të përçarë mes tyre; dhe pjesërisht sepse vetë udhëheqësit e tu janë të pasigurt dhe të pavendosur. Ndërkohë, shtypësit janë

të sigurt dhe të bashkuar, dhe ata e ndiejnë fitoren që po afrohet. Në fund, dështimi yt është i plotë. Tani Kosova është dëshmia tragjike e kësaj të vërtete.
Nëntëmbëdhjetë muaj më parë, NATO dërgoi një forcë në Kosovë. Presidenti Clinton më pas deklaroi se angazhimi i Amerikës ishte i palëkundur. Ai foli me mençuri për “të drejtën e të gjithë njerëzve, shqiptarë dhe serbë njësoj, për të jetuar në paqe dhe siguri”. “Ne nuk kërkojmë ta ndëshkojmë Serbinë”, tha ai. “Ne kërkojmë ta ndryshojmë atë.” Zëdhënësit rusë thanë se bombardimet ishin të paligjshme, por parashikuan se ato do të funksiononin. Nuk funksionuan. Presidenti Millosheviç i mbijetoi vullnetit tonë. Deri në tetor, ai po priste me padurim dimrin dhe fitoren.

Në asnjë moment, derisa Serbia pothuajse nuk kishte shpallur vendimin për t'u tërhequr, askush në Perëndim nuk diskutoi seriozisht kuptimin e fitores: pavarësinë për Kosovën. Ky kishte qenë gjithmonë qëllimi i Millosheviçit: eliminimi i kombit shqiptar, të cilin ai ishte betuar ta shkatërronte.
Një pjesë e suksesit të Millosheviçit buronte nga përçarja e Perëndimit; pjesa tjetër nga dobësia dhe mungesa e vendosmërisë së Amerikës për të përdorur forcën e saj dërrmuese. Por arsyeja kryesore ishte refuzimi ynë kolektiv për të përcaktuar qartë objektivin: pavarësimin e Kosovës dhe çlirimin e saj përfundimtar nga zgjedha serbe. Disa komentatorë perëndimorë e konsideronin pavarësinë e Kosovës një zgjidhje "tepër ekstreme". Por lufta nuk njeh rrugë të mesme. Në fund, ose fiton, ose

humbet. Millosheviçi e kishte kuptuar këtë më mirë se shumë prej kundërshtarëve të tij. Për vite me radhë ai e veshi kete politika te eger ekspansioniste me vendosmeri.
Ai mobilizoi “serbët e tij” jo vetëm me armë, por edhe me një politikë sistematike mizorie, duke e shpallur qartë synimin e tij: krijimin e Serbisë së Madhe. Sipas tij, kombi shqiptar nuk kishte të drejta mbi tokën e vet dhe e vetmja e ardhme që u rezervohej shqiptarëve të Kosovës ishte varri ose dëbimi në Turqi. Parulla e tij ishte e qartë: “Arbanasi, shkoni në Turqi!”
Megjithatë, shumica e amerikanëve dhe evropianëve zgjodhën të mos dëgjonin. Ata këmbëngulnin se zgjidhja duhej kërkuar brenda kornizës së Jugosllavisë dhe Serbisë. Pse? Sepse kjo u dukej “pragmatike”; sepse e quanin “realiste”; sepse druheshin nga ajo që

e etiketonin si “ekstremizëm” apo “paqëndrueshmëri”. Por historia ka treguar se nuk mund të ketë stabilitet mbi themelet e padrejtësisë.

KOMBËSIA - JO NDARJA E TERRITORIT TË KOSOVËS ËSHTË E VETMJA ZGJIDHJE E DREJTË.

Pa një vizion të qartë, çdo fitore bëhet më e vështirë për t’u arritur. Çlirimi i Kosovës do të vijë një ditë, por sa më shumë të vonohet drejtësia, aq më i vështirë do të jetë ndërtimi i një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme. Shqiptarët nuk mund të jetojnë nën sundimin serb. Çdo zgjidhje që mbetet më pak se pavarësia do të prodhojë vetëm më shumë refugjatë, më shumë urrejtje dhe më shumë luftë.

Pavarësia e Kosovës është në interes të Amerikës. Ajo do të forcojë autoritetin moral

të Shteteve të Bashkuara dhe do ta bëjë botën më të sigurt për miqtë dhe aleatët e saj. Por ajo është edhe në interes të Rusisë. Udhëheqësit rusë mund të deklarojnë se kundërshtojnë bombardimet, por ata e dinë më mirë se kushdo se mbështetja për Millosheviçin e lidh Rusinë me dështimet dhe krimet e Serbisë, duke e dobësuar pozitën dhe prestigjin e saj në arenën ndërkombëtare.

Pavarësia e Kosovës është në interes të Evropës. Ajo do të krijojë kushtet për një stabilizim të qëndrueshëm të Ballkanit dhe do të forcojë pozitat e të gjithë atyre që besojnë në një Evropë të bashkuar, të lirë dhe të ndërtuar mbi parimet e demokracisë dhe vetëvendosjes së popujve.

Ajo është edhe në interes të vetë Serbisë. Milloshevići i ka shkaktuar tashmë plagë të

rënda popullit dhe shtetit serb dhe po i shtyn ata drejt fatkeqësive edhe më të mëdha. Vetëm pas largimit të tij nga pushteti, Serbia do të ketë mundësinë të rimëkëmbet, të pajtohet me fqinjët e saj dhe të zërë vendin e merituar në familjen e kombeve demokratike. Serbët dhe të tjerët që mbeten besnikë ndaj së kaluarës përsërisin vazhdimisht vetëm një fjalë: “Jo!”. Në mendjen e tyre, “Jo” pavarësisë së Kosovës nënkupton mbrojtjen dhe ruajtjen e kombit të tyre.

Prapëseprapë, nacionalizmi nuk ka ruajtur asnjë komb. As versioni i nacionalizmit serb të Millosheviçit nuk do t’i mbajë serbët të sigurt në Kosovë apo gjetkë. Ai nuk do ta ruajë Serbinë. Ai vetëm do të sjellë më shumë luftë, më shumë shkatërrim dhe më shumë izolim. Nacionalizmi serb tashmë ka dëmtuar rëndë pjesët më të mira të kulturës serbe dhe

i ka bërë serbët të humbin respektin e botës. Ka ardhur koha t'i thuhet "Jo!" një vizioni të rremë të kombit.

Vetëm një koncept i shtetësisë dhe i identitetit kombëtar që është në përputhje me lirinë dhe demokracinë ka të ardhme. Pavarësia e Kosovës është në përputhje me lirinë dhe demokracinë për të gjithë. Ajo ofron shpresën e një Evrope në paqe me vetveten. E ardhmja e Kosovës është pjesë e së ardhmes së Evropës. Nëse Evropa dështon tani, ajo do të dobësojë veten dhe do të tradhtojë vlerat e saj më të larta. Bashkimi Evropian nuk mund t'i predikojë botës moralin nëse nuk i jeton vetë ato vlera, këtu dhe tani, në Kosovë. Sa më gjatë që Evropa ta vonojë njohjen dhe konsolidimin e plotë të pavarësisë së Kosovës, aq më e dobët do të bëhet në arenën ndërkombëtare.

Udhëheqja e Presidentit Clinton e ka ruajtur forcën dhe ndikimin amerikan dhe ka frymëzuar shpresat e miliona njerëzve. Mos lejoni tani që historia të regjistrojë një tjetër dështim të guximit politik. Pavarësia e Kosovës është e vetmja bazë për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.
Mbështeteni pavarësinë e Kosovës.
Mbështeteni popullin e Kosovës në luftën e tij heroike dhe paqësore për liri. Udhëhiqeni botën drejt kësaj mundësie të fundit dhe më të mirë për të korrigjuar një padrejtësi të tmerrshme. Shfrytëzojeni këtë mundësi para se të humbasë.
Tani ora është vonë, por ende jo tepër vonë. Nëse Amerika, Evropa dhe Rusia zgjedhin tani rrugën e drejtësisë dhe të ndershmërisë

— pavarësinë e Kosovës — atëherë e ardhmja mund të jetë ndryshe. Ajo mund të jetë një e ardhme e paqes, e lirisë dhe e dinjitetit për të gjithë popujt e rajonit.

Përktheu Mal Berisha

Proud to be Albanian!